




REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës
Nr. 002/20
Datë: 27.09.2018

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe nenit 14 paragrafi 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 10 paragrafi 10.2 dhe paragrafi 10.3 të Ligjit për Tokën Bujqësore (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 13/2007) dhe nenit 8 paragrafi 8.4 të Udhëzimit Administrativ për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore në Tokë Ndërtimore (U.A. Nr. 41/2006) dhe nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4. të Statutit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 27.09.2018, duke vendosur sipas kërkesës së subjektit afarist “Oda e Junikut” të cilën e përfaqëson Fatjon Shala, nxjerrë:

V E N D I M

Paraparak

Për shndërrimin e përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore

I. Me këtë vendim ndërrohet destinimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

II. Parcelës kadastrale me numër P-488-0, 487-2, 487-4, 486-6, 486-8, 486-12, 486-14 me sipërfaqe të përgjithshme prej 40473 m² zona kadastrale Junik me kulturë tokë bujqësore e klasës së 5-të në vendin e quajtur Baks-Mali i Dranocit i ndërrohet destinimi i sipërfaqes prej 40473 m² nga shfrytëzimi aktual si tokë bujqësore në tokë ndërtimore.

III. Parcelat kadastrale nga pika II. e këtij vendimi pas nxjerrjes së vendimit përfundimtar duhet të evidentohen si toka ndërtimore në Planin Zhvillimor Komunal.

IV. Kompensimi për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas pikës I. të këtij vendimi do të paguhet në procedurë administrative me rastin e aplikimit për leje ndërtimi sipas kriterëve të parapara me nenin 14 paragrafi 14.2 pika a) të Udhëzimit Administrativ për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore (U.A. Nr. 41/2006).

V. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

VI. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis e Komunës së Junikut.


VII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muharrem Zekrisliq





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës
Nr. 002/21
Datë: 27.09.2018

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe nenit 14 paragrafi 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 10 paragrafi 10.2 dhe paragrafi 10.3 të Ligjit për Tokën Bujqësore (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 13/2007) dhe nenit 8 paragrafi 8.4 të Udhëzimit Administrativ për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore në Tokë Ndërtimore (U.A. Nr. 41/2006) dhe nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4. të Statutit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 27.09.2018, duke vendosur sipas kërkesës së znj. Sevdije Dervishaj, nxjerrë:

V E N D I M

Paraparak

Për shndërrimin e përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore

I. Me këtë vendim ndërrohet destinimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

II. Parcelat kadastrale me numër P-2325-0,2326-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 7909 m² zona kadastrale Junik me kulturë tokë bujqësore e klasës së 2-të në vendin e quajtur Berishë-Jazina i ndërrohet destinimi i sipërfaqes prej 7909 m² nga shfrytëzimi aktual si tokë bujqësore në tokë ndërtimore.

III. Parcelat kadastrale nga pika II. e këtij vendimi pas nxjerrjes së vendimit përfundimtar duhet të evidentohen si toka ndërtimore në Planin Zhvillimor Komunal.

IV. Kompensimi për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas pikës I. të këtij vendimi do të paguhet në procedurë administrative me rastin e aplikimit për leje ndërtimi sipas kriterëve të parapara me nenin 14 paragrafi 14.2 pika a) të Udhëzimit Administrativ për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore (U.A. Nr. 41/2006).

V. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

VI. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis e Komunës së Junikut.


VII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës së Junikut;

Numër: 02/22

Datë: 27.09.2018 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), nenit 16 paragrafi 9 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 paragrafi 8.1. të Rregullores mbi transparencën, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 27.09.2018 nxjerrë:

V E N D I M

**për hapjen e diskutimit publik për
projekt Rregulloren për Punën e Kuvendit të Komunës së Junikut,**

- I. Me këtë vendim **hapet diskutimi publik** për plotësim ndryshimin e projekt Rregullores për punën e Kuvendit Komunal të Komunës së Junikut/ në tekstin e mëtejshëm projekt Rregullorja/.
- II. Projekt Rregullorja nga pika I. e këtij vendimi vihen në dispozicion të publikut për shqyrtim publik dhe komente.
- III. Të gjitha propozimet dhe vërejtjet që paraqiten nga publiku brenda afatit kohor prej 15 ditëve do të përfshihen në raportin e shqyrtimit publik.
- IV. Ekspozimi i projekt Rregullores do të bëhet në zyrën për administratë të përgjithshme të objektit të Komunës së Junikut.
- V. Diskutimi publik i projekt Rregullores zgjat 15 ditë (fillon më: 03.09.2018 dhe përfundon më: 23.09.2018).
- VI. Gjatë kohës së diskutimit publik projekt Rregullorja ekspozohet edhe në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe komente.
- VII. Diskutimi publik i projekt Rregullores organizohet nga Komuna e Junikut respektivisht Drejtoria për Administratë të Përgjithshme e Komunës së Junikut.
- VIII. Organizatori është i obliguar që të hartojë planin e veprimit dhe organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së diskutimit publik të kësaj projekt Rregulloreje.
- IX. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Administratë të Përgjithshme e Komunës së Junikut.

X. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha vendimet e mëparshme me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.


XI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për Administratë të Përgjithshme;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit të
z. Muharrem Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/23
Datë: 27.09.2018 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), nenit 16 paragrafi 9 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 paragrafi 8.1. të Rregullores mbi transparencën, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 27.09.2018 nxjerrë:

V E N D I M

për hapjen e diskutimit publik për projekt Rregulloren për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve,

- I. Me këtë vendim **hapet diskutimi publik** për projekt Rregulloren për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve / në tekstin e mëtejme projekt Rregullorja/.
- II. Projekt Rregullorja nga pika I. e këtij vendimi vihen në dispozicion të publikut për shqyrtim publik dhe komente.
- III. Të gjitha propozimet dhe vërejtjet që paraqiten nga publiku brenda afatit kohor prej 15 ditëve do të përfshihen në raportin e shqyrtimit publik.
- IV. Ekspozimi i projekt Rregullores do të bëhet në zyrën për administratë të përgjithshme të objektit të Komunës së Junikut.
- V. Diskutimi publik i projekt Rregullores zgjat 15 ditë (fillon më: 03.09.2018 dhe përfundon më: 23.09.2018).
- VI. Gjatë kohës së diskutimit publik projekt Rregullorja ekspozohet edhe në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe komente.
- VII. Diskutimi publik i projekt Rregullores organizohet nga Komuna e Junikut respektivisht Drejtoria për Administratë të Përgjithshme e Komunës së Junikut.
- VIII. Organizatori është i obliguar që të hartojë planin e veprimit dhe organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së diskutimit publik të kësaj projekt Rregulloreje.
- IX. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Administratë të Përgjithshme e Komunës së Junikut.


X. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha vendimet e mëparshme me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.


XI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për Administratë të Përgjithshme;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/24
Datë: 27.09.2018 .

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1. të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (Ligji Nr. 03/L-204, GZRK numër 88/2010); nenit 7 paragrafi 1. të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (Ligji Nr. 04/L 100, GZRK numër 14/2012); nenit 12.2 paragrafi d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 22.1 paragrafi 4. të Statutit të Komunës së Junikut; dhe nenit 16 paragrafi 11. të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 27.09.2018, nxjerrë:

V E N D I M

për miratimin e

Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019

I. Me këtë vendim miratohet **Rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019**/në tekstin e mëtejme Rregullorja/.

II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja e miratuar nga pika I. e këtij vendimi.

III. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.

IV. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.


V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
Kuvendi Komunal – JUNIK - Skupština Opštine - Municipal Assambly

RREGULLORE PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2019

JUNIK

SHTATOR , 2018

Bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 12.2 pika c, Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr. 03/L-204, datë 7 Tetor 2010 si dhe Ligjit Nr. 04/L-100 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme Nr. 03/L-204, datë 20 Prill 2012, dhe Statutit të Komunës neni 20 Kuvendi Komunal i Junikut në mbledhjen e vet të mbajtur me datë: 27.09.2018, aprovon këtë:

RREGULLORE MBI TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME

Neni 1

Duke u bazuar në Nenin 6 dhe 13 të Ligjit mbi Tatimin në Pronë të Paluajtshme Nr. 03/L-204 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2011 për përcaktimin e vlerës së pronës së paluajtshme dhe standardet e vlerësimit, baza tatimore për 2019 nga Komuna e Junikut do të caktohet si më poshtë:

Tabela 1. Zonat tatimore në bazë të vlerës së tregut në m²

Zonat	Pronat Rezidenciale		Komercale, Restaurantet, Hotelet/Dyqan, Zyrë	Industriale/Fabrikë, Punishte/Punëtori	Bujqësore/Ferma komerciale/Hudhurat e peshqve	Komercale-Pishina/Fushë sportive të hapura dhe të mbyllura.	Garazh/Parking	Komercale-Depo/Magazinë	Pronat e përfunduara
	Banesat	Shtëpitë							
I	330	330	450	260	150	120	150	260	120
I-A	300	300	400	215	120	120	120	210	95
II	270	270	340	190	95	120	95	190	85
III	190	190	270	140	40	95	40	140	70
IV	140	140	180	85	20	95	20	85	30

Neni 2

Bazuar në vlerën e tregut të pronave të paluajtshme, territori i Komunës së Junikut ndahet në pesë zona tatimore, siç vijon:

Zona e parë - përfshin të gjitha objektet që kanë dalje në të dy anët e rrugës magjistrale dhe lokale, ku përfshin rrugën nga Qendra e Junikut e deri të Biblioteka “Dinë Mehmeti”, rruga nga Qendra e Junikut deri te Stacioni i Autobusëve, rruga nga Qendra e Junikut e deri te stacioni policor, rruga nga Qendra e Junikut (rruga për Dobrosh) e deri të udhëkryqi i rrugës së Berishës dhe rruga nga Qendra e Junikut e deri te Qendra e Mjekësisë Familjare.

Zona e parë A - përfshirë gjitha objektet që kanë dalje në rrugën kryesore nga Biblioteka “Dinë Mehmeti” e deri në Qendra për Punë dhe Mirëqenie Sociale, rruga nga stacioni i

autobusëve deri ne restorant “Oda e Junikut” , rruga nga stacioni policor e deri te varrezat e Gacaferit, rruga nga udhëkryqi i Berishës e deri te bunari i fushës, rruga nga Qendra e Mjekësisë Familjare e deri në palestra sportive “Ereniku”.

Zona e dytë - përfshinë të gjitha objektet dhe lokale pas përfundimit të zonës së parë A sipas nenit 3.2. dhe objektet tjera të banimit në lagjet: Gacafer, Pepsh, Bajraktarë, Berishë, Miroc-Malok , **Qok**, Gaxherr i Ulët dhe i Epërm dhe lagja Agim Ramadani - e cila dallon nga zona industriale.

Zona e tretë - përfshinë të gjitha hapësirat të cilat nuk janë të përfshira në zonën I-rë dhe zonës II -të, e që i përkasin Qytetit të Junikut: lagja **Goç** dhe objektet tjera të banimit të cilat gjenden në periferi të lagjeve të cekura në zonën e dytë.

Zona e katërt - janë të përfshira te gjitha hapësirat jashtë Qytezës së Junikut: fshatrat Gjocaj, Jasiq.

Neni 3

Ne baze te Ligjit për tatimin ne prone Nr. 03/L-204 dhe në pajtim me Nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-100 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tatimin në pronën e paluajtshme Nr. 03/L-204, normat tatimore mbi pronën ne bazë vjetore ne shkallen tatimore janë të përcaktuara prej 0.15% (zero pikë pesëmbëdhjetë për qind) deri ne 1% (një për qind) te vlerës se pronës ne treg.

Tabela 2 Norma tatimore për Komunën e Junikut për vitin 2019

Nr.	Kategoria e pronës	Norma tatimore
1.	Prona Rezidenciale –Shtëpi/Banesë	0.15%
2.	Pronë Komerciale – Restorant/Hotel/Dyqan/Zyre	0.17%
3.	Prona Industriale - Fabrikë, Punishte/Punëtori	0.16%
4.	Komerciale - Pishina noti/fushë sportive te mbyllura dhe te hapura	0.17%
5.	Prona bujqësore - Ferma komerciale/Hudhrat e peshqve	0.15%
7.	Garazh/Parking	0.15%
8.	Komerciale - Depo/Magazinë	0.16%
9.	Pronat e pa përfunduara	0.15%

Neni 4

Ne bazë te nenit 5, paragrafi 1.8 pika 1.8.1, te Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2011 për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatimpaguesin, gjendja e pronës dhe norma e kualitetit për vlerësimin e objekteve ndahet ne pese kategori dhe është siç vijon:

Nr.	Gjendja e pronës	Norma e kualitetit
1.	E Shkëlqyeshme	1.1
2.	E Mirë	1.0
3.	Mesatare	0.8
4.	E Dobët	0.6
5.	Shumë e dobët	0.5

Neni 5

Pronat të cilat lirohen nga tatimi në pronën e të cilat janë të cekura në Nenin 8 të Ligjit mbi Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr.03/L-204 lirohen nga tatimi edhe në Komunën e Junikut.

Neni 6

Shtyrja e pagimit të tatimit në kushte të veçanta mund të bëhet konform Nenit 16 pika 1, 2, 3, 4, 5 të Ligjit mbi Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr. 03/L-204, dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2011.

Neni 7

Bazuar në Ligjin e Tatimit në Pronë Nr.03/L-204, Neni 3, paragrafi 1.1. parasheh se tokat dhe ndërtesat, stabilimentet, godinat në sipërfaqen e tokës dhe që janë të lidhura me tokën duhet të tatimohen. Vlerësimi i ndërtesave bëhet në bazë të çmimit për m² ndërsa Vlerësimi i Stabilimenteve bëhet në bazë të metodës së kostos apo çmimit kushtues të saj.

Neni 8

7.1 Në pajtim me nenin 11, pika 1.4 të Ligjit mbi Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr. 03/L-204 mbi përgjegjësitë komunale, dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 5/2011 Neni 2 pika 1,2,3,4,5. Kryetari i komunës së Junikut emëron Bordin e Komunal për shqyrtimin e Ankesave administrative të tatimpaguesve në afat një(1) viti.

Neni 9

8.1 Ligjit Nr.03/L-204 i datës 7 Tetor 2010 për "Tatimin në Pronën e Paluajtshme" dhe 9 Udhëzimet Administrative rregullojnë të gjitha çështjet tjera të cilat kanë të bëjnë me tatimin në pronën e paluajtshme e të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore Komunale të tatimit në pronën e paluajtshme për vitin 2018.

Neni 10

9.1 Pas aprovimit nga Kuvendi Komunal, Rregullorja e tatimit në pronën e paluajtshme për vitin 2019 hynë në fuqi, 7 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, duke u bazuar në nenin 81 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale.

Neni 11

10.1 Më hyrjen në fuqi të Rregullores për tatimin në prone për vitin 2019, shfuqizohet (bie poshtë) Rregullorja e tatimit në pronën e paluajtshme e vitit 2018.

KUVENDI I KOMUNËS JUNIK

Datë: _____
Nr. _____

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Muharrem Krasniqi

